

**RAPORT MBI  
MBIKËQYRJEN PARLAMENTARE TË POLITIKAVE ENERJETIKE DHE INVESTIMEVE NË  
ENERGJI**

*“Mbikëqyrje parlamentare të politikave energjetike dhe investimeve në energji”*



6 dhe 7 shtator 2014  
Budvë, Mal i Zi

## 1. *Përmbledhje*

**Rreth 75 deputet dhe staf parlamentar nga parlamentet e Ballkanit Perëndimor së bashku me përfaqësues nga ministritë për ekonomi dhe energji, kompani për prodhim të energjisë dhe distribucion, organe rregulluese dhe ekspertë për energji u takuan në Budvë, në konferencë rajonale që u mbajt më 6 dhe 7 shtator, qëllimi i të cilës ishte *“Mbikëqyrja parlamentare e politikave energjetike dhe investimeve në energji”***

Konferenca u hap nga z. Suljo Mustafiç, zëvendës kryetari i parlamentit të Malit të Zi, duke thënë:

“Ekziston nevoja për përforsim të bashkëpunimit rajonal në sektorin e energjisë, dhe themelimi i një mjedisi stabil rregullues dhe tregu stabil, paraqesin parakushte për tërheqje të investimeve në sektorin energjetik. “ Z. Mustafiç theksoi se:

“Çështja e përforsimit të bashkëpunimit rajonal në sektorin e energjisë gjithashtu u diskutua në një konferencë mbi Ballkanin Perëndimor, që u mbajt në Berlin para do kohe dhe këto takime janë mundësi të rralla për shkëmbim mendimesh mbi definicionet e praktikave më të mira të mbikëqyrjes së zbatimit të politikave në energji.”

Gjatë konferencës dy ditore panelistët dhe pjesëmarrësit shkëmbyen këshilla dhe argumente për “Traktatin e Komunitetit Energjetik dhe Pakon e Tretë Energjetike – Sfidat legjislative për parlamentet në Ballkanin Perëndimor”, “Ardhmërinë e zgjedhjeve për energji të ripërtëritshme – Zgjedhje legjislative dhe mbikëqyrje e praktikave më të mira”, “Investime në energji në Ballkanin Perëndimor – Nevojat e ardhshme dhe implikimet për të ardhmen.” Dhe “Roli i organeve për rregullim të energjisë dhe roli i parlamenteve në mbikëqyrjen e organeve rregullatore dhe politikave energjetike”.

Z. Aleksandar Damjanoviç, kryetar i bordit të NPC dhe kryetar i Komisionit për Ekonomi, Financa dhe Buxhet në parlamentin e Malit të Zi, theksoi rëndësinë e bashkëpunimit të vazhdueshëm rajonal në fushën e energjisë duke thënë:

“Idea e organizimit të konferencës për pjesëmarrësit dhe tema që mbulojmë sot erdhi nga një prej rekomandimeve nga takimet trepalëshe mes anëtarëve të komisioneve parlamentare përgjegjës për sektorin e energjisë nga Parlamenti i Malit të Zi, Kuvendit Kombëtar të Republikës së Serbisë dhe Kuvendit Kombëtar të Republika Srpska, që u realizua në mars të këtij viti, në Trebinje.

Është e rëndësishme të përforsohet mbikëqyrja e politikave energjetike dhe investimeve në energji, që këto politika mos të përcaktohen dhe zbatohen në in rrethe të ngushta të autoriteteve ekzekutive dhe biznes sektorin.”

Veç kësaj, z. Damjanoviç theksoi se: Aktivitetet për themelimin e Kuvendit Parlamentar për Komunitetin Energjetik, ide që u prezantua bashkërisht nga deputet nga Ballkani Perëndimor në korrik të këtij viti, në selinë e Komunitetit Energjetik në Vjenë duhet të vazhdojnë.”

Përfaqësues nga ministritë për ekonomi dhe energji, kompanitë për prodhim dhe distribucion të energjisë, organe rregullatore dhe ekspert për energji nga rajoni ofruan këndvështrimin tyre si panelistë dhe pjesëmarrës në konferencë.

Si rezultat i konferencës, pjesëmarrësit kanë miratuar konkluzione që duhet të shërbejnë si udhëzues për përf forcimin e rolit që e kanë në procesin e mbikëqyrjes mbi politikat energjise në Ballkanin Perëndimor.

Përfundimisht, u akorduan që: **“Rrjeti rekomandon dhe përkrah themelimin e Kuvendin Parlamentar për Komunitetin Energjetik, që do të bashkon anëtarët e Parlamentit Evropian dhe deputetët e palëve kontraktuese të Komunitetit Energjetik.”**

Konferenca është organizuar nga Rrjeti i Komisioneve Parlamentare për Ekonomi, Financa dhe Integrim Evropian në Ballkanin Perëndimor (RRKP), me përkrahjen e Westminster Fondacionit për Demokraci (WFD).

**Konkluzione dhe rekomandime nga konferenca rajonale mbi "Mbikëqyrjen parlamentare të politikave energjetike dhe investimeve në energji në Ballkanin Perëndimor".**

Gjatë diskutimeve në konferencën rajonale në Budva, Mali i Zi, më 6 dhe 7 shtator, ishin diskutuar disa pika kryesore nga deputetët dhe ekspertët në fushën e energjisë nga Ballkani Perëndimor.

- A. Parlamentet kanë rol të kufizuar në mbikëqyrjen e investimeve në sektorin e energjisë dhe mbikëqyrjen e politikave energjetike dhe ka nevojë për angazhim më të madh të parlamenteve të Ballkanit Perëndimor për këtë çështje.
- B. Kapacitetet administrative dhe financiare të vendeve individuale të Ballkanit Perëndimor në tërheqjen e investimeve në energji janë të kufizuar; andaj, qasja e përbashkët rajonale për investime në energji është mënyra më e mirë e ecjes përpara për zhvillimin e ardhshëm të sektorit energjetik në Ballkanin Perëndimor.
- C. Vonesat në zbatimin e ligjeve të energjisë që rrjedhin nga traktati i komunitetit të energjisë janë të dukshme dhe duhet një bashkëpunim i përbashkët me Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë për monitorim të zbatimit.

**Konkluzione dhe rekomandime nga Rrjeti i Komisioneve Parlamentare për Ekonomi, Financë dhe Integrim Evropian në Ballkanin Perëndimor**

- 1. Rrjeti e njih rëndësinë e investimeve të ardhshme në sektorin energjetik për zhvillimin e gjitha vendeve të rajonit dhe Parlamentet e Ballkanit Perëndimor kanë rol crucial në promovimin e themelimit të një tregu të përbashkët energjetik dhe të mbështesin projekte investuese në sektorin energjetik.
- 2. Parlamentet janë të inkurajuar të angazhojnë komunitetin akademik, afarist, investitorët dhe shoqërinë civile dhe aktorët tjerë jo-shtetëror në mbikëqyrjen e politikave të energjisë me anë të kyçjes së tyre në punën e komisioneve relevante parlamentare.
- 3. Rrjeti inkurajon parlamentet e rajonit të angazhohen në të ardhmen gjatë diskutimeve të dokumenteve energjetike. Strategjitë rajonale duhet të jenë në përputhje me strategjitë kombëtare të vendeve të Ballkanit Perëndimor.
- 4. Rrjeti inkurajon parlamentet dhe komisionet parlamentare të zhvillojnë një kulturë të mbikëqyrjes me anë të seancave të rregullta vjetore për zbatimin e ligjeve që janë të miratuar si pjesë e obligimeve që dalim nga Traktati i Komunitetit të Energjisë, në bashkëpunim me autoritetet e rregullimit të vendeve përkatëse.
- 5. Rrjeti duhet të ndërmerr aktivitetin e zhvillimit të pakove dhe veglave për trajnim dhe të bëjë përpjekje për pajisjen e deputetëve dhe stafin e parlamentit me njohurinë dhe veglat e nevojshme për të mbështetur mbikëqyrjen e politikave të energjisë.

*Në fund, u theksua që*

***Rrjeti rekomandon dhe mbështet themelimin e Asamblesë Parlamente të Komunitetit të Energjisë, e cila do të bashkojë anëtarët e Parlamentit Evropian dhe anëtarët e parlamenteve që janë pale kontraktuese të Traktatit.***

**KONFERENCË PARLAMENTARE PËR MBIKËQYRJEN E POLITIKAVE ENERGETIKE DHE INVESTIMEVE  
NË ENERGI "MBIKËQYRJE PARLAMENTARE E POLITIKAVE ENERGETIKE DHE INVESTIMEVE NË  
ENERGI"**

**6-7 shtator, 2014  
Budvë, Mal i Zi**

**5 shtator 2014**

Arritja e pjesëmarrësve në hotel Splendid - Budva

20:30                      Recepton mirëseardhjeje (koktej - hotel Splendid) - Bari pranë pishinës

**6 shtator 2014**

**Ju lutemi vini re:** *Dita e parë e konferencës do të mbahet në Hotel Montenegro, që është pranë hotelit Splendid, 2 minuta në këmbë. Ju lutemi ndiqni shenjat dhe udhëzimet. Stafji i hotelit dhe WFD gjithashtu do t'ju drejtojnë tek hoteli Montenegro.*

**09:30 – 10:00**                      Regjistrimi i pjesëmarrësve (Hotel Montenegro – Salla Tara)

**10:00 – 10:15**                      Fjalimet kyçe

**z. Suljo Mustafic** - Zëvendës kryetar i parlamentit malazez

Hyrje nga: z. Emil Atanasovski Drejtues i Programit të Westminster Foundation for Democracy për Ballkanin Perëndimor

**10:15 – 12:15**                      Paneli 1 "Traktati energjetik dhe Pakoja e 3-të energjetike – Shqyrtimi)  
*Ndryshimet legjislative dhe sfidat legjislative për parlamentet në Ballkanin Perëndimor*

**znj. Vesna Borozan** - Profesori Sistemeve Energjetike në Universitetin "Shën Kirili dhe Metodi" – Shkup;

**znj. Zeljka Tomic** – Drejtuese e sektorit juridik në Agjencinë Rregullatore të malit të Zi;

**z. Mirza Kusljugic** – Profesor universitar dhe deputet në Parlamentin e Bosnjës dhe Hercegovinës;

**znj. Aleksandra Tomic** – Kryetare e Komisionit për Ekonomi, Zhvillim rajonal, Tregti, Turizëm dhe Energji në Parlamentin e Republikës së Serbisë.

**12:15 – 13:30**                      Drekë (Hotel Montenegro)

**13:30 – 15:30**                      Paneli 2 "Ardhmëria e zgjedhjeve të qëndrueshme energjetike. Zgjedhje legjislative dhe mbikëqyrje e praktikave më të mira"

**z. Aleksandar Damjanovic** – Kryetar i Komisionit për Ekonomi, Financa dhe Buxhet në parlamentin e Malit të Zi;

**z. Arben Dhima** - Drejtues i Departamentit për Politika Energjetike dhe Zhvillim në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë së Republikës së Shqipërisë

**z. Sasa Boskovic** – deputet dhe anëtar i Komisionit për Ekonomi në Parlamentin Kombëtar të Republika Srpska



**znj. Dragica Sekulic** – Drejtoreshë e Drejtorisë për Efikasitet Energjetik pranë Ministrisë së Ekonomisë, Qeveria e Malit të Zi

- 15:30 – 15:45      Pauzë për kafe
- 15:30 – 15:45      Konkluzione nga dita e parë
- 20:00              **Darkë (Hotel Splendid)**

7 shtator 2014

**Ju lutemi vini re** *Ditën e dytë konferenca do të zhvillohet në Hotel Splendid*

- 09:30 – 10:00      Regjistrimi i pjesëmarrësve, dita 2 (Hotel Splendid – salla Petrovic)
- 10:00 – 10:05      Hyrje në ditën e 2 nga Aleksandar Damjanovic– Kryetar i bordit të NPC
- 10:05 – 12:00      Paneli 3 “Investimet energjetike në Ballkanin Perëndimor. Nevojat dhe implikimet në të ardhmen”
- z. Vladimir Kavaric** – Ministër i Ekonomisë në Qeverinë e Malit të Zi (duhet konfirmuar);  
**akad. Momir Djurovic** – Kryetar i Akademisë së Shkencave dhe Artit;  
**z. Atanasko Tuneski** - Profesor në universitetin “Shën Kirili dhe Metodi” – Shkup  
**z. Predrag Popovski** - Profesor në universitetin “Shën Kirili dhe Metodi” – Shkup
- 12:00 – 13:00      Drekë (Hotel Splendid)
- 13:00 – 15:00      Paneli 4 “Roli i organeve rregullatore dhe roli i parlamenteve në mbikëqyrjen e organeve rregullatore dhe politikave energjetike”
- z. Milenko Cokorilo** – Kryetar i Agjencisë rregullatore për energji të Republika Srpska;  
**z. Enver Halimi** – Kryetar i bordit të Zyrës së rregullatorit të energjisë në Kosovë;  
**z. Branislav Prelevic** – Kryetar i bordit të Agjencisë rregullatore të energjisë në Mal të Zi.
- 15:00 – 15:15      Pauzë për kafe
- 15:15 – 15:45      Përmbledhje dhe konkluzione nga secili panel dhe rekomandime nga konferenca  
**z. Aleksandar Damjanovic** – Kryetar i Komisionit për Ekonomi, Financa dhe Buxhet në Parlamentin e Malit të Zi;  
**z. Emil Atanasovski** Drejtues i Programit të Westminster Foundation for Democracy për Ballkanin Perëndimor
- 20:00              **Recepcioni përmbyllës i konferencës (Restorant Lim)**

**Ju lutemi vini re:** WFD do të organizon transportin prej Hotel Splendid tek Restoranti Lim

Largimi i pjesëmarrësve është ose më 7 shtator, ose më 8 shtator, varësisht prej agjendës së tyre të largimit.